

Akreditohen 261 institucione shëndetësore



Në Ditën Botërore të Mbulimit Shëndetësor Universal janë akredituar 261 spitale dhe qendra shëndetësore në të gjithë vendin. Gjatë ceremonisë së organizuar me këtë rast, Ministria Manastirliu u shpreh se procesi i akreditimit ka qenë një proces i gjatë dhe sfidues për plotësimin e standardeve të strukturave shëndetësore. Janë 4 Spitale Universitare, 11 Spitale Rajonale, 19 Spitale Bashkiake, 225 Qendra Shëndetësore dhe 2 klinika jopublike që u akredituan. Ligji i ri i Kujdesit Spitalor nëpërmjet modelit të Autonomisë Spitalore ka bërë të mundur që të hapë një tjetër rrugë drejt pagesave dyfishe, drejt pagesës për performancë, drejt efijencës dhe efikasitetit të përdorimit të burimeve, drejt modelit të ri të autonomisë spitalore, i cili fillon me Spitalin Memorial në Fier, duke e aplikuar nga fillimi i vitit 2023.



PUNËSOHEN 335 MJEKË TË RINJ NGA PORTALI "MJEKË PËR SHQIPËRINË"

Gjatë vitit 2022, nëpërmjet portalit 'Mjekë për Shqipërinë' janë punësuar 335 mjekë në të gjithë vendin. 190 mjekë të përgjithshëm janë punësuar në qendrat shëndetësore dhe ambulancat, për të ofruar shërbim dhe kujdes cilësor. Që prej fillimit të funksionimit të portalit "Mjekë për Shqipërinë" janë punësuar 1026 mjekë, ndërsa me portalin "Infermierë për Shqipërinë" janë punësuar këtë vit 900 infermierë.

DREJT PËRFUNDIMIT 40 QENDRA TË REJA SHËNDETËSORE

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka inspektuar punimet që po kryhen për rehabilitimin e qendrës shëndetësore Muçaj në Vorë, e cila po rehabilitohet në kuadër të fazës së dytë të programit të 300 qendrave shëndetësore. Me fillimin e fazës së dytë të këtij projekti do të rehabilitohen 40 qendra shëndetësore, ndërsa në vijim, me buxhetin e vitit 2023 do të rehabilitohen 60 qendra të tjera shëndetësore, duke e çuar në 400 numrin e qendrave të rindërtuara.



PUNËSOHEN 50 PSIKOLOGË NË QENDRAT SHËNDETËSORE

Nis ofrimi i shërbimit social pranë qendrave shëndetësore. 50 psikologë janë punësuar në 50 qendrat e para shëndetësore të cilat do të funksionojnë sipas modelit socio-shëndetësor në të gjithë vendin. Shqipëria është ndër vendet e para në rajon që po zbaton reformën e shërbimeve të integruara socio-shëndetësore në sistemin shëndetësor. Përfshirja e figurës së psikologut/punonjësit social si pjesë e stafit të qendrës shëndetësore sjell një qasje gjithëpërfshirëse multidisiplinare të ekipit për ofrimin e shërbimeve të integruara në komunitet, të cilat do të plotësohen dhe me profesionistë të tjerë të shkencave mjekësore, si logopedë dhe fizioterapistë.

PËRFUNDON MASTERPLANI I INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK

Përfundon projekti i Masterplanit të Institutit të Shëndetit Publik. ISHP është projektuar me kapacitete të shtuara dhe për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes, në digjitalizim dhe zhvillim të mëtejshëm nga pikëpamja shkencore dhe nga pikëpamja organizative. Finalizimi i masterplanit të Institutit të Shëndetit Publik do të vijojë me konkretizimin e tij gjatë vitit 2023. Faza e parë fillon me ndërtimin e godinës së laboratorëve që fillon në vitin 2023, një investim i siguar nga buxheti i shtetit dhe më pas me godinën qendrore të Institutit të Shëndetit Publik.

